

PASHKA 2006

### **Krishti u Ngjall! Vërtet u Ngjall!**

Të Vyerve dhe të Përndershmëve Klerikë, Monahë dhe Besimtarë të  
Kishës Ortodokse në Amerikë

Kjo është dita e Ngjalljes! Le të ndriçohemi prej saj!  
Le të përqafohemi me njëri-tjetrin! Le t'u themi 'vëllezër' edhe atyre që na urrejnë,  
dhe të falim të gjitha nëpërmjet Ngjalljes! (Stihira e Pashkës)



Të dashurit e mi në Krisht,

Në udhëtimin tonë drejt Pashkës, ne i afrohem njëri-tjetrit duke kërkuar dhe duke ofruar falje, duke qenë ky hapi i parë esencial në rrugën e pendimit. Sot, duke festuar përfundimin e udhëtimit tonë, ne festojmë atë falje që vjen nga varri i zbrazur, atë falje që rrëzon muret e ndarjes dhe na fton të përqafojmë miq dhe armiq së bashku për hir të Atij, i Cili na thërret që të marrim natyrën e Tij divine.

Larg nga të qenit një festim i ngjarjeve të kaluara, proklamimi ynë i Ngjalljes është i rrënjësor në një ngjarje që tejkalon kohën dhe hapësirën. Kështu që, ne me të vërtetë marrim pjesë në një realitet që është i kudondodhshëm dhe që kurrë nuk perëndon, që bashkon ata që kanë ikur përpara nesh me ata që do të vijnë, në një festim të përjetshëm të shembullit të përkryer dhe të përjetimit të dashurisë së treguar njerëzimit. Ne, në të njëjtën kohë, qëndrojmë me gratë në hyrjen e varrit dhe në mesin a Mbretërisë së përjetëshme të Perëndisë. Zemrat tona janë të ndriçuara. Sytë tanë janë të hapur kur Shpëtimtari i Ngjallur na fton të shikojmë përtej kujdesjeve dhe hidhërimeve të kësaj bote, në gëzimet e premtuara në jetën e botës që do të vijë. Smira dhe pasionet, sqima dhe urrejtja bëhen të pakuptimshme kur bëhemi pjesëmarrës së fitores së përjetëshme dhe atëherë kur jeta e re na është ofruar kaq lirisht prej Krishtit, Ngadhënjimtarit të përjetshëm.

Pikërisht kur filluam udhëtimin tonë me thirrjen për të kërkuar dhe ofruar falje, po atëherë, gjithashtu, edhe gëzimi i vërtetë i Pashkës së Shenjtë është i përmbushur në mëshirim. Shpëtimtari ynë nuk bën kompromise në këtë pikëpamje. Etërit e Shenjtë na kujtojnë që zjarri i ngrohtë i dashurisë së Perëndisë me të vërtetë na pastron dhe na bën të papërlyer kur ne afrojmë njëri-tjetrin me dashuri, por në të njëjtën kohë, na bën të mundohemi dhe të vuajmë atëherë kur zemrat tona janë te ftohta dhe ngurtësohen, kur kërkojmë falje ndër kohë që nuk dimë ta ofrojmë atë, kur ne refuzojmë t'i përqafojmë të tjerët me atë "puthje të shenjtë" të faljes, qoftë edhe për hirt të Ngjalljes.

Të themi se jetojmë në kohë të turbullta, të mbushura me zemërim dhe urrejtje, është një minimizim. Lajmet dhe pamjet e luftës dhe frikës, veprimeve çnjerëzore dhe vdekjes, përshkëndijnë çdo ditë përpara syve tanë. Bota shikon agresionin si një shenjë të fuqisë, kurse falja dhe pajtimi janë të para si një shenjë të dobësisë. Përsëri, në mes të kësaj rrëmuje, drita e varrit të zbrazur shkëlqen akoma më shumë tek ata që përqafojnë Shpëtimtarin e ngjallur, Dritën e botës "e Cila asnjëherë nuk mund të

mposhtet nga errësira” dhe i Cili na fton që të lemë dritën tonë të ndriçojë përpara njerëzimit.

Qoftë që të bëhemi të denjë prej thirrjes tonë, duke u ofruar të gjithëve atë falje të shenjtë që Zoti ynë, me aq begati, ua jep atyre që e pranojnë dhe e ofrojnë atë. Dhe qoftë që gëzimi i përjetshëm i Mbretërisë së Tij të na përsosë këtu dhe tani, edhe pse ne parapresim përmbushjen e të gjitha gjërave në Krishtin e Ngjallur.

Me dashuri në Zotin e Ngjallur,



+ HERMAN

Kryepeshkop i Uashingtonit dhe Nju Jorkut  
Mitropolit i Gjithë Amerikës dhe Kanadasë